

VENDIM
Nr. 191, datë 6.3.2013

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT NDRYSHUES TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT,
NDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA), PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT “RRUGËT SEKONDARE DHE LOKALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 17 e 27 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e dokumentit ndryshues të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për financimin e projektit “Rrugët sekondare dhe lokale”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha